



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2020:070662

Datë: 18.10.2022

Numri i dokumentit: 03539850

C.nr.271/20

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-Dega Kaçanik, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Riza Livoreka, duke vendosur në çështjen juridiko-civile të paditësit Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, Rr.“Lidhja e Pejës”, Magj Prishtinë-Fushë Kosovë, pa nr., të cilën e përfaqëson O. Q. me autorizim, e punësuar në ...“Sh.p.k , me seli në Prishtinë , me adresë, Rruga “..., B.II, nr 2, kundër të paditurit F. (V...) Sh., nga fshati ..., Komuna Kaçanik, për çështjen kontestuese rimbursim i dëmit, në praninë e të autorizuarit të paditësit dhe të paditurit, në seancën kryesore të mbajtur me datë 29.09.2022, mori dhe shpalli, ndërsa me datë 18.10.2022, bëri përpilimin me shkrim të keti :

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET, kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, e ushtruar me datën 12.06.2020 , kundër të paditurit F. (V...) Sh. nga fshati ..., Komuna Kaçanik, me të cilën ka kërkuar rimbursim dëmit në vlerë prej 1,209.00€, në tërsi SI E PA BAZUAR

II.DETYROHET paditësi Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë Rr.“Lidhja e Pejës”, Magjistralja Prishtinë-Fushë Kosovë, që të paguaj kësaj gjykate t ia paguaj shumën prej 30€ në emër të taksës për padi, e cila pages do të bëhet në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Paditësi Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, me datë 12.06.2020, në këtë gjykatë ka parashtruar padi, kundër të paditurit F. Sh., nga fshati ..., Komuna Kaçanikut, me të cilin ka kërkuar rimbursimin e dëmit në shumë prej 1,209.00€, Po ashtu me këtë padi këtë shumë e ka kërkuar me kamatë prej 8%, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive.

Paditësi ka thekësuar se me datën 16.11.2017, rreth orës 16:00 në afërsi të fshatit Gajre në Kaçanik ka shkaktuar aksident të komunikacionit me automjetin e tij "...", me targ të regjistrimit 05-619-BN, i cili automjet në momentin e aksidentit ishte pa mbules siguruese respektivisht me afat të skaduar të regjistrimit.

Pastaj ka sqaruar se deri tek aksidentit ka ardhur nga pakujdesia e tani të paditurit gjatë lëvizjes dhe nga goditja i ka shkaktuar dëm të dëmtuarit H. R. të cilin dëm tani paditësi ia ka paguar të dëmtuarit. Paditësi këtë dëm e ka kërkuar duke u bazuar në nenin 18 të Ligjit për Sigurin e Detyrueshme të autopërgjegjshis Nr.04/1-018 nga këtë baza ka kërkuar që kërkespadia të aprovet në tërsi si e bazuar.

Shpenzimet i ka kërkuar në emër të taksës për padi.

I padituri si në përgjigje në padi, ashtu edhe në seancën përgatitore e ka kontestuar kërkespadin e paditësit dhe i ka propozuar gjykatës që të njejtën ta refuzoj në tërsi si të pa bazuar. I padituri ka theksuar se pala paditëse as me padi e as në seancë nuk e ka vërtetuar se jam shkaktar i këtij aksidenti nuk ka prezentuar asnjë prov me të cilën do ta vërtetonte fajsin time në shkaktimin e këtij aksidenti.

Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

Gjykata për ta vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në këtë çështje juridike civile me propozimin e palës paditëse e zhvilloi procedurën e provave duke e bërë leximin e këtyre provave të shkruara, -U lexua: transferi nga kontoja, pajtimi gjyqësore, raporti i aksidentit, raporti specialistik, përgjigja në padi nga i paditur, përgjigja në padi e datës 30.03.2018, pa pyetje dhe pa vërejtje.

Pas analizimit të provave në tërësi dhe të secilës veç e veç si dhe konform nenit 8 të LPK-së, dhe bindjes së lirë të gjykatës, gjykata lidhur me këtë çështje kontestimore juridiko civile vërtetoi këtë gjendje faktike:

Aksident i komunikacioni ka ndodhur më datën 16.11.2017, në këtë aksident dëm ka psuar H. R.. Padiësi këtë dëm e ka paguar por me asnjë prov nuk e ka vëretuar se me veprimin e të paditurit është shkaktuar ky dëm.

a) Se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur më datën 16.11.2017, këtë fakt gjykata e ka vëretuar nga thënjet në padi, raporti i aksidentit 2017 Ce.518 i datës 16.11.2017, ku është shënuar se më datën 16.11.2017 në ora 16:00 në rrugën e fshatit Gajre në Kaçanik ka ndodhur aksident i komunikacionit në mes të tani paditurit dhe të dëmtuarit tani H. R. nga fshati ..., ky faktë nuk ishte kontestues mes palëve.

b) Se tani padiësi e ka paguar këtë dëm këtë fakt gjykata e ka vëretuar nga thënjet në padi nga provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës e në veqanti nga trasferit bankar dhe pajtimi gjyqësor e nga të cilat prova vërtetohet se Byroja kosovare e Sigurimit ia ka paguar dëmin e shkaktuar të dëmtuarit H. R..

c) Pala padiëse me asnjë provë nuk e ka vërtetuar faktin se ky aksident është shkaktuar me fajin apo me përgjegjsin e të paditurit F. Sh. edhe pse gjatë me padi dhe në seancën përgatitore është pretenduar nga pala padiëse se ky aksident është shkaktuar me fajin e të paditurit. Gjatë tër procesit në asnjë provë nuk ka mundur ta vërtetoj faktin se ky dëm është shkaktuar me fajin e të paditurit edhe pse gjatë tër procesit palëve ndërgjygjëse u është munduar të paraqesin prova për ti vërtetuar faktet e pretenduara ndërsa këtë nuk e ka bërë pala padiës.

Gjykata pas analizimit të theksimeve në padi, theksimeve në seancën përgatitore e refuzoi kërkesëpadinë e padiësës në tërësi si të pabazuar për faktin se me asnjë provë nuk u vërtetua kërkesëpadia e padiësës si e bazuar, për shkak se gjendja e paraqitur nga pala padiëse nuk rezultoi të ishte në përputhje me asnjë provë të bashkangjitur në shkresat e lëndës e obligim i secilës është që pala padiëse të paraqesë prova për t'i vërtetuar faktet e pretenduara, kjo konform Nenit 7 paragrafi 1 i LPK-së. Me këtë dispozitë thuhet se: “Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me

të cilat konstatohen faktet e tilla”, andaj në kuptim të kësaj dhe në bazë të provave të administruara, gjykata konstatoi se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar, rrjedhimisht gjykata nuk gjeti arsyeje për të aplikuar dispozita tjera konkrete të Ligjit mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësisë, pasi që bazueshmëria e kërkesës rezultoi si e dështuar, prandaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mbi bazën e kësaj gjendje të vërtetuar faktike e cila u vërtetua në mënyrë të plotë dhe të drejtë që rezultoi nga të gjitha provat e nxjerra dhe të vlerësuara, gjykata vlerëson se janë eliminuar të gjitha faktet kontestuese për vendimmarrje dhe kërkesëpadinë e paditëses e refuzoi në tërësi si të pa bazuar sepse me nenin 136 par 1 të LMD-së është e parapar se kush i shkakton tjetërit dëm ka për detyr ta kompenzoj përveq se nëse vëretohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij e në rasi konkret pala paditëse ka dështuar ta vëretoj se dëmi është shkaktuar me fajin e tani paditurit dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata i analizoi theksimet e palës paditëse e cila ka kërkuar që të detyrohet e cila si në padi ashtu edhe në seancën përgatitore ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet i padituri tia rimbursoj dëmin në shumë prej 1,209€ sepse ky dëm i është shkaktuar me fajin e tani të paditurit, por këto theksime i refuzoi si të pa bazuara sepse pala paditëse me asnjë provë (ekspertiz komunikacioni, aktgjykim), nuk e ka vërtetuar se aksidenti i shënuar më lartë është shkaktuar me fajin e tani të paditurit. Gjykata e ka analizuar edhe pretendimin e palës paditëse se i padituri ka detyrim ta paguaj dëmin e kërkuar sepse ka qen duke drejtuar automjetin pa sigurim mirpo këtë pretendim gjykata nuk e mori për bazë me rasiin e vendosjes sepse mos pasj e sigurimit nuk është provë se i njejt është shkaktar i aksidentit e për ta detyruar të paditurin për ta paguar këtë duhet të vërtetohet se egziston fajsia ashtu siq është parapar me nenin 136 të LMD-së

Gjykata i analizoi edhe pretendimet e të paditurit i cili me përgjigje në padi dhe seancë përgatitore e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit dhe i ka propozuar gjykatës që të njejtën ta refuzoj. Gjykata këtyre theksimeve ua fali besimin sepse pala paditëse me asnjë provë nuk e ka vëretuar se me fajin e të paditurit është shkaktuar aksidenti i komunikacionit.

Gjykata e detyroi palën paditëse që ta paguaj shumë prej 30€ në emër të taksës për padi, sepse pala paditëse nuk ka vepruar konform nenit 253 pik 4 të LPK-së me të cilën dispozitë është parap se paditësi ka për detyr padis tia bashkangjes vërtetimin mbi taksën gjyqsëore të

paguar e pala paditëse këtë fakt nuk e ka vëretuar. Gjykata ka vepruar sipas udhëzimit administrativ nr.01/2017 të Këshillit Gjyqësorë të Kosovës, gjykata vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e ka bazuar në nenin 452.1, të LPK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

C.nr.271/20 datë 29.09.2022

Gjyqtari
Riza LIVOREKA

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit të Kosovës përmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.

Ekspeduar më datën 18.10.2022

Paditësit 1x1

Të paditurit 1x1